



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:165987

Datë: 14.10.2021

Numri i dokumentit: 02377823

P.1009/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtaren Fitore Daci, si dhe me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.A. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.Nr.1534/2020, datë 26.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Besnik Nuredini, të dëmtuarës M.D., si dhe të pandehurit A.A., me datë 14.10.2021 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A.A., i lindur me datë ..., nga i ati H., e ëma M., e gjinisë H., me vendbanim në Prishtinë, rruga "...", numër ..., kati ..., banesa me numër ..., i gjendjes së dobët ekonomike, i shkurorëzuar, baba i gjashtë fëmijëve, shfrytëzues i asistencës sociale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 27 tetor 2020, rreth orës 09:30, në sallën e Gjykatës Themelore në Ferizaj, gjatë prezantimit të fjalës përfundimtare, me qëllim të frikësimit apo shkaktimit të ankthit seriozisht e kanos të dëmtuarën M.D., me fjalët “Po t’i kisha shkaktuar lëndimet, nga këto lëndime sot

nuk do të qëndroje në këmbë, kjo për të cilën akuzohem nuk ka qenë asgjë nga ajo e cila do t'i shkaktoj në të ardhmen sepse ky rast është vetëm fillimi nga ajo çfarë do pësoj nga unë tani e dëmtuara”.

Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë nenit 181 par.1 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3/tre/muaj, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara M.D., me vendbanim Ferizaj, rruga ‘...’, ka heq dorë nga e drejta e realizimit të kërkesës pasurore juridike.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20€ /njëzet euro/, në afatin prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit.

Detyrohet i pandehuri që në emër të fondit për kompensimin e Viktimave të Krimit të e paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën të evidentuar PP/II.nr.1534/2020 të datës 26.11.2020 ka ngarkuar të pandehurin A.A. nga Ferizaj, për veprën penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së, si dhe mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.04.2021, në të cilën shqyrtim i pandehuri A.A. është deklaruar se: nuk e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza.

Pas kalimit të afatit për paraqitjen e kërkesës për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimit të provave, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 14.10.2021, në të cilin shqyrtim i akuzuari A.A., ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën me ngarkon aktakuza, më vjen keq që e kam kryer këtë vepër penale, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë, po ashtu pendohem për faljet të cilat i kam thënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 27.10.2021, kërkoj nga gjykata që gjatë matjes së dënimit të i ketë parasysh kushtet e mija ekonomike, jam mbajtës i familjes, kam 6 fëmijë si dhe jetoj në banesë me qera.

Prokurori i shtetit Besnik Nuredini, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit meqë i njëjti pranim është i bazuar në gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, pranimin e fajësisë i njëjti e bën vullnetarisht, ngaqë një pranim i tillë është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 si dhe provat të cilat gjenden në lëndë si dhe gjatë matjes së dënimit Gjykata të ketë parasysh pranimin e fajësisë dhe të i shqiptoj dënim sipas ligjit.

E dëmtuara M.D., në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se: nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk paraqes kërkesë pasurore-juridike, e tërë kjo për faktin se unë kam bashkëjetuar me të pandehurin për dy vite rresht, sjellja e tij gjatë këtyre viteve ka qenë shumë e mirë, mirëpo pas ndarjes sonë ka filluar me lloj-lloj akuze ndaj meje, tani më jemi ndarë dhe sjellja e tij ndaj meje ka filluar të përmirësohet dhe më nuk më ka shkaktuar probleme të tjera.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes edhe faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: procesverbali i seancës gjyqësore 27.10.2020, i përpiluar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, me rastin e paraqitjes e fjalës

përfundimtare të palëve, kallëzimin penal me numër 2020-CF-1768, dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabim faktik.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik, vlerësimin të tyre një nga një në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimin të tillë vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri e ka pranuar fajësinë, si rrethanë tjetër lehtësuese i mori faktin e pendimit të sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, gjendjen tejet të dobët ekonomike, i shkurorëzuar, baba i gjashtë fëmijëve, mbajtës i familjes si dhe mos bashkëngjitjen ndaj ndjekjes penale nga ana e të dëmtuarës, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori faktin se vepra penale është kryer brenda objektit të Gjykatës, ndaj ish bashkëjetueses së tij, me të cilën kanë bashkëjetuar për dy vite së bashku, në të njëjtën shtëpi, po ashtu faktin se i pandehuri është i dyshuar edhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 336 par.2 të KPRK-së, PPRKR.Nr.27/21, e cila veprë ndërlidhet me veprën penale të Kanosjes, faktin se është i gjykuar me Aktgjykimin me numër P.Nr.945/18 të datës 14.11.2018, për veprë të njëjtë penale. Gjykata po ashtu vlerësoi edhe shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

E dëmtuara M.D., me vendbanim Ferizaj, rruga ‘...’, ka hjek dorë nga e drejta e realizimit të kërkesës pasurore juridike.

Vendimi për pagesën e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 par.1, të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.Nr.1009/20, datë 14.10.2021**

Bashkëpunëtori Profesional

Gjyqtarja

Shkelzen Polloviqi

Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.